# DËSHMI ARKIVI

**A-468773**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Raportet tona, kurrë më të mira", Trump i dhuron Xi Jinping një shqiponjë të SHBA-së |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/raportet-tona-kurre-me-te-mira-trump-i-dhuron-xi-jinping-nje-shqiponje-te-shba-se/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 12:17:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 12:12:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 12:11:00 UTC → 25 shtator 2026, 12:13:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `33f44bda80af265e8c20fafd84be7a33edd7581f2ff11d3d816cd08514d4a025` |
| TEKSTI | `60423fff9a261bde5e0c072fd2eed3f722369fad738a1bab521b7ba8c6001283` |
| PAMJA | `fe8779f0fbb53b36f2973a0450134b7ce307a4daa0bfd8dff4f00659e32d5869` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5cfab8b7b23c5e0a800945a4985f995f07bda464f04c4bcb7da85b93b2dffa7f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5cfab8b7b23c5e0a800945a4985f995f07bda464f04c4bcb7da85b93b2dffa7f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# “Raportet tona, kurrë më të mira”, Trump i dhuron Xi Jinping një shqiponjë të SHBA-së

25/09/2026 14:12



Një banket madhështor u shtrua në Shtëpinë e Bardhë në nder të presidentit kinez Xi Jinping. Të dy liderët shfrytëzuan atmosferën e ngrohtë festive të mbrëmjes për të lëvduar raportin e tyre, teksa e përshkruan takimin si një kapitull të ri miqësie mes dy vendeve.

“*Po shohim dëshmi të marrëdhënies së gjatë dhe të çmuar mes dy vendeve tona, diçka vërtet e jashtëzakonshme. Por shohim shkëmbimet kulturore mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara, ashtu siç bënë paraardhësit tanë, të cilët shekuj më parë shtrinë dorën përtej oqeanit për të tregtuar, për të mësuar dhe për të ndërtuar një botë më të mirë. Ne sot po bëjmë të njëjtën gjë, dhe për këtë, jemi shumë krenarë. Duke punuar së bashku, presidenti Xi dhe unë kemi bërë përparime të jashtëzakonshme për çështjet me të cilat përballen vendet tona. Gjatë vizitës sime të fundit, në maj, krijuam Bordin e Tregtisë. Është një mekanizëm krejt i ri dhe ka qenë jashtëzakonisht i suksesshëm, me ekipet tona që punuan për të nxitur një marrëdhënie tregtare më të ekuilibruar*”, u shpreh Trump.

Xi tha nga ana e tij se të dyja vendet “duhet të veprojnë si fuqi të mëdha të përgjegjshme për t’iu përgjigjur pritshmërive të popujve tanë”, ndërsa Trump ngriti një dolli për një të ardhme me “harmoni, paqe dhe sukses”. Në fund, presidenti amerikan i dhuroi homologut kinez statujën e një shqiponje kokëbardhë, simboli i SHBA-së. “Nuk kemi shkuar kurrë më mirë me njëri-tjetrin,” tha Trump.

Por analistët politikë janë më gjakftohtë në grafinë që i bëjnë kësaj vizite. Ata thonë se ndalesa e parë e Xi Jinping në Shtetet e Bashkuara që prej 2015-tës nuk solli ndonjë përparim të qënësishëm për çështjet më urgjente. Përveç zgjatjes me dy muaj të atij që mund të konsiderohet një lloj “armëpushimi” në mosmarrëveshjet tregtare dhe angazhimit për të pezulluar deri më 10 janar tarifat e larta ndëshkuese dhe kufizimet e eksportit, nuk u njoftuan zhvillime të rëndësishme sa i takon temave delikate si inteligjenca artificiale, statusi i Tajvanit, ndikimi i Kinës në Iran dhe mbështetja kineze për Rusinë në luftën në Ukrainë.

Mosmarrëveshjet mes SHBA-së dhe Kinës mbeten të shumta, nga tregtia dhe çipat deri te Tajvani, Irani dhe lufta në Ukrainë.

**Top Channel**


## Kryesore



Anulohet tenderi 50 milionë euro për hemodializën, ministrja e re e Shëndetësisë ndalon procedurën
13:33

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim
09:59

Moti ‘përmbys’ planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë
10:41

Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje
09:47

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb
10:27

## Më të lexuarat

“Ku jemi katandisur!”/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë

“Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?”/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

“Dumani përzuri Vlorën nga zyra”, Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

Top Story/ “Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë”, gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

“Burg, burg”, një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj

## Bota »










Zhdukja e adoleshentes pa asnjë gjurmë/ Del emri i tretë në hetim, rrëfimi për telefonatën misterioze të vitit 1983

25/09 14:03




Polemika rreth librit për Princeshën Diana, i vëllai hedh akuza ndaj Mbretit Charles. Reagon Pallati Mbretëror

25/09 13:57




Zjarr i madh në një traget pranë Mykonos, evakuohen 29 persona/ Flakët nisën nga një kamion

25/09 13:39

"Bëra gabim që qëllova me shishe"/ Delina Fico zbulon për "Shqipëria Live" se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin

Top Story/ "Mbrojtja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt



Greqia po kthen trurin/ Përmirësimi i ekonomisë, kthehen grekët e kualifikuar që emigruan në Gjermani

25/09 13:25



Alarm në detin Egje/ Përfshihet nga zjarri një traget, evakuohen 29 persona

25/09 13:18



Vdekja e Giorgos Mazonakis, dalin detaje të reja nga klinika: Defibrilatori nuk po funksiononte

25/09 13:02

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »




Top News – Sherr masiv mes adoleshentëve. Ndërhyn policia, procedohen 23 prej tyre



Top Channel/ Shpërthim i fuqishëm, shembet ndërtesa dykatëshe, plagoset një kalimtar



Top Channel/ "Gratë me funde të gjata janë nëna më të mira"! Italia zien, ja si përgjigjen deputetet



Top News – Putin dërgon avionët mbi Finlandë… / Finlanda e Suedia i gjurmojnë, mision i përbashkët



Top Channel/ Ambasadori i Bullgarisë në Pustec, Ivajlo Kiro:E drejtë që njerëzit të protestojnë



Top News – Trump i jep Ukrainës Patriotët / Zelenski konfirmon: Ka marrë vendimin përfundimtar



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.